



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.656/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Goran Milenković - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues, Z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Joos & krasniqi-Bazë” SH.P.K- Junik, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Grupi i Operatorëve ekonomik: “Marisa” SH.P.K- & “Company Murseli” SH.P.K- Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe çiklizëm Qabrat-Jahoc” me nr. të prok: 632-20-1308-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Gjakovë” më datën: 21.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Joos & krasniqi-Bazë” SH.P.K- Junik, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe çiklizëm Qabrat-Jahoc” me nr. të prok: 632-20-1308-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK-Gjakovë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe çiklizëm Qabrat-Jahoc” me nr. të prok: 632-20-1308-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Gjakovë” dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Joos & krasniqi-Bazë” SH.P.K- Junik, i aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Joos & krasniqi-Bazë” SH.P.K- Junik, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 11.09.2020 me nr. 656/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Grupi i Operatorëve ekonomik: “Marisa” SH.P.K- & “Company Murseli” SH.P.K- Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe çiklizëm Qabrat-Jahoc” me nr. të prok: 632-20-1308-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Gjakovë” duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 2, 7, 24 pika 2, 51, 56, 59, si dhe neni 60 i LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 23.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 05.10.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: “Joos & krasniqi-Bazë” SH.P.K- Junik,

Sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit:

Me dt 28.05.2020 ne si koncerzium i kemi dërguar në kopje fizike dokumentet e kërkuara në AK Komuna e Gjakovës si dhe Sigurimin mbi Ekzekutimin e Punimeve. Ne jemi shpallur fitues nga AK Komuna e Gjakovës me dt: 28.05.2020.

Mirëpo, ka pasur ankesa në AK dhe lënda është kthyer në Rivlerësim, pas Rivlerësimit me dt 23.06.2020 AK

Komuna e Gjakovës na njofton që kompani fituese e këtij tenderi është konceriumi: Marisa SH.P.K & Company Murseli. Ky koncerzium ne vlershmin e parë është eliminuar për arsye se nuk e ka dorëzuar Sigurimin e Tenderit, mirëpo ka dorëzuar një sigurim tjetër që nuk përputhet me dosjen e tenderit. Pas vendimit të marrur nga AK Komuna e Gjakovës me shpallje fitues të këtij koncerziumi ne kemi kërkuar qasje në dokumente të operatorëve ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Me qasjen tonë në dokumente të Operatorëve ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës: Marisa SH.P.K & Company Murseli, kemi vërejtur se ky koncerzium nuk është i përgjegjshëm, dokumentet të cilat i mungojnë koncerziumit në fjalë janë: Sigurimi i Tenderit Gabim, ku e dijmë se tek RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK thuhet se nëse “Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT” –Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm 57.

Me,dt.28.08.2020 AK-Komuna e Gjakovës na njofton mbi vendimin e marr, ku prapë rekomandojnë një grup te operatorëve ekonomik te pa përgjegjshëm për shpërblim me kontratë. AK-Komuna e Gjakovës nuk e ka respektuar vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit me nr 463/20 të datës 07.08.2020, vendim me të cilin thuhet qe AK gjatë Rivlerësimit obligohet dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Si dhe grupin e operatorëve ekonomik të cilin AK Komuna e Gjakovës e ka rekomanduar për dhënie te kontratës, OSHP ka thënë se duhet te refuzohet tenderi i tyre për arsye qe sigurimin e tenderit nuk e kanë konform Dosjes se Tenderit.

Përgjigja e AK-së në kërkesën për rishqyrtim:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 04.07.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues, konstaton se Grupit të operatorëve ekonomik “Marisa” sh.p.k.& “Company Murseli” sh.p.k., është me çmimin më të ulët, prandaj Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Sa ju përket juve, tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye se çmimi i juaj nuk është më i ulëti në mesin e tenderëve që plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.


Eksperti Shqyrtues sqaron se lidhur me këtë pretendim OSHP ka sqaruar dhe ka nxjerr vendimin 463/20 të datës 07.08.2020:

Andaj paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi i ankuesit për sigurimin e tenderit për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës është i pa bazuar, për faktin se Sigurimi i tenderit në ofertë është i ngarkuar komplet gabimisht, qe sigurimi i tenderit ndërlidhet krejtësisht me një aktivitet tjetër të prokurimit, numër tjetër të prokurimit, ku gjithashtu edhe nuk është i plotësuar plotësisht (mungon nënshkrimi i të siguruarit, shumia është gabim. Andaj paneli shqyrtues në pajtim me nenin 39 të RRUOPP konstaton se nëse sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara, tenderi duhet të refuzohet, ashtu siç edhe përcaktohet tek neni 39 pjesa 57 të RRUOPP në të cilin thuhet:

Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57
---	---	----

Andaj ky pretendim i OE ankuesit është i bazuar, për faktin se Sigurimi i Tenderit nuk tolerohet të ngatërrohet dhe se sipas LPP-së nëse Ofertuesi nuk i plotëson kriteret e FDT-së shpallet i pa përgjegjshëm.

Eksperti Shqyrtues në mënyrë që ta analizojë lëndën në mënyrë sa më objektive, ka kërkuar sqarime nga AK: (Shih më poshtë e-mailin):



Dhe sqarimi i KRPP-së:

From: Rregullat Krpp
Sent: Wednesday, August 19, 2020 3:10 PM
To: Venera Shtaloja
Subject: Re: Kërkesë mendimi

Të nderuar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron dispozitat e LPP-së dhe të legjislacionit dytësor si në vijim:

Autoritetet kontraktuese gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit gjithmonë duhet ta mbajnë në mend qëllimin e këtij ligji të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1 të LPP-së.

Sipas nenit 59 të këtij ligji, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e Autoritetit Kontraktues.

Paragrafi 4 i nenit 59 të këtij ligji, përcakton:

"4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".

Në përputhje me nenin 47.19 të RRUOPP, Neni 59.4 i LPP-së lejon autoritetin kontraktues që të pranojë ofertat, në raste të gabimeve ose paqartësive dhe në raste të devijimeve të vogla. Në të dyja rastet është një kusht që aspektet materiale të njoftimit për kontratë / dosjen e tenderit nuk janë prekur.

Një sqarim më të detajuar të paragrafit 4 të nenit 59 të LPP-së, përmban neni 47.21 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, i cili përcakton:

"47.21 Neni 59.4 i LPP-së kërkon që gabimet dhe mangësitë duhet të korrigjohen dhe që devijimet e vogla duhet të kuantifikohen. Gabimet dhe mangësitë janë të ndryshme nga ato aritmetike që trajtohen në nenin 41.9 të këtyre rregullave dhe këtij udhëzuesi. Gabimet dhe mangësitë mund të jenë tekstuale ose ato mund të prekin aspekte të tjera të tenderit. Gabimet tekstuale dhe mangësitë duhet të jenë objektivistisht shumë të qarta dhe se autoriteti kontraktues të jetë në gjendje të identifikimit të tyre si gabime dhe mangësi! Çdo paqartësi apo kundërthënie që nuk mund lehtë të identifikohet si një gabim apo mangësi nuk mund të korrigjohet. Autoriteti kontraktues duhet në raste të tilla të vazhdojë duke kërkuar sqarim në bazë të nenit 59.2 të LPP. Kuantifikimi i devijimeve të vogla ka për qëllim të neutralizimit të efektit që këto devijime do të

kenë në krahasimin e tenderëve. Llogaritja duhet të përfundojë duke u shprehur në disa vlera të shprehura në terma monetare".

Sipas paragrafit 4 të nenit 59 të LPPs-së, është në përgjegjësi të Autoriteti Kontraktues që t'i përcaktojë devijimet në tender. Autoriteti Kontraktues duhet të vendos vet se çështja në fjalë a mund të konsiderohet si devijim i vogël që nuk mund të shkaktoj ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Me respekt,
Arbnora Cakolli-Luzha,
Kordinatore e Departamentit të Rregullave-KRPP.

.....
Vërejtje: Interpretimi i dhënë nga KRPP, i referohet vetëm pyetjes së parashtruar nga ana juaj dhe asesi nuk i dedikohet aktivitetit të prokurimit.

Eksperti Shqyrtues konsideron se ky interpretim i KRPP-së nuk është i qartë dhe shumë sqarues në mënyrë që ta shpjegon më saktësisht se a merret si e mirëqenë Sigurimi i bashkangjitur gabim ose jo, por KRPP më tepër ka interpretuar vetëm nenet 47.9, 59.2, 41.9 të LPP-së dhe RRUOPP-së, dhe në fund duke e përmbledhur tekstin me: citat' (Sipas paragrafit 4 të nenit 59 të LPP-së, është përgjegjësi e AK që të përcaktojë devijimet në tender.)

Mirëpo vlen të theksohet se KRPP në RRUOPP tek parashtrimi i pyetjeve e ka sqaruar këtë detaj shumë qartë, pra Sigurimi i tenderit nuk i përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë e DT, në rastin konkret është po e njëjta arsye:

Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	57
---	--	----

Eksperti Shqyrtues konsideron se nëse KRPP mendon që bashkëngjitja gabimisht e dokumenteve jashtë kriterëve të parashtruara nga AK në FDT nëse të gjitha duhet të sqarohen sipas nenit 59 të LPP-së dhe të mbeten në diskrecion të AK-së!!, atëherë Ligji nr 04/L-042 do të ishte i pa nevojshëm.

Nga çka u tha më lartë, bashkëngjitja gabim e Sigurimit tenderit në rastin konkret është në kundërshtim me RROUPP dhe LPP e cila e shpallë OE-në të pa përgjegjshëm.

Mendimi i ekspertës shqyrtuese:

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet dhe vendimi i AK-së të anulohet, dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 05.10.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 09.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk - pajtohet me mendimin e ekspertës shqyrtuese.

Operatori Ekonomik, me datë: 05.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertës shqyrtuese.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 21.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Joos & Krasniqi-Bazë” SH.P.K- Junik, se me dt 28.05.2020 ne si koncerzium i kemi dërguar në kopje fizike dokumentet e kërkuara në AK Komuna e Gjakovës si dhe Sigurimin mbi Ekzekutimin e Punimeve. Ne jemi shpallur fitues nga AK-Komuna e Gjakovës, me dt: 28.05.2020. Mirëpo, ka pasur ankesa në AK dhe lënda është kthyer në Rivlerësim, pas Rivlerësimit me dt 23.06.2020 AK Komuna e Gjakovës na njofton që kompani fituese e këtij tenderi është konceriumi: Marisa SH.P.K & Company Murseli. Më, tej OE ankues shton se ky koncerzium ne vlershmin e parë është eliminuar për arsye se nuk e ka dorëzuar Sigurimin e Tenderit, mirëpo ka dorëzuar një sigurim tjetër që nuk përputhet me dosjen e tenderit. Pas vendimit të marrë nga AK Komuna e Gjakovës, me shpallje fitues të këtij koncerziumi ne kemi kërkuar qasje në dokumente të operatorëve ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës. Me qasjen tonë në dokumente të Operatorëve ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës: Marisa SH.P.K & Company Murseli, kemi vërejtur se ky koncerzium nuk është i përgjegjshëm, dokumentet të cilat i mungojnë koncerziumit në fjalë janë: Sigurimi i Tenderit Gabim, ku e dijmë se tek RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK thuhet se nëse “Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT” –Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm 57. Tutje OE ankues shton se me dt.28.08.2020 AK-Komuna e Gjakovës na njofton mbi vendimin e marr, ku prapë rekomandojnë një grup të operatorëve ekonomik te pa përgjegjshëm për shpërbllim me kontratë. AK-Komuna e Gjakovës nuk e ka respektuar vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit me nr.463/20 të datës 07.08.2020, vendim me të cilin thuhet qe AK gjatë Rivlerësimit obligohet dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit

dhe njoftimit për kontratë. Si dhe grupin e operatorëve ekonomik të cilin AK Komuna e Gjakovës e ka rekomanduar për dhënie të kontratës, OSHP ka thënë se duhet të refuzohet tenderi i tyre për arsye që sigurimin e tenderit nuk e kanë konform Dosjes së Tenderit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK në përgjigja e kërkesën për rishqyrtim potencon: AK konstaton se grupi i OE të rekomanduar për kontratë “Marisa” SH.P.K- & “Company Murseli” SH.P.K- Gjakovë, është me çmimin më të ulët, prandaj Autoriteti Kontraktues mbetet pranë vendimit të marrë. Sa ju përket juve, tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye se çmimi i juaj nuk është më i ulëti në mesin e tenderëve që plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se lidhur me këtë pretendim OSHP ka sqaruar dhe ka nxjerr vendimi nr 463/20 të datës 07.08.2020 ku është konstatuar: *“Andaj paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi i ankuesit për sigurimin e tenderit për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës është i pa bazuar, për faktin se Sigurimi i tenderit në ofertë është i ngarkuar komplet gabimisht, që sigurimi i tenderit ndërlidhet krejtësisht me një aktivitet tjetër të prokurimit, numër tjetër të prokurimit, ku gjithashtu edhe nuk është plotësuar plotësisht (mungon nënshkrimi i të siguruarit, shuma është gabim) “Andaj Paneli Shqyrtues në pajtim me nenin 39 të RRUOP konstaton se nëse sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara, tenderi duhet të refuzohet, ashtu siç edhe përcaktohet tek neni 39 pjesa 57 të RRUOPP në të cilin thuhet: Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë e DT; Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtijshëm 57;*

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankuesit është i bazuar, për faktin se Sigurimi i Tenderit nuk tolerohet të ngatërrohet dhe se sipas LPP-së nëse Ofertuesi nuk i plotëson kriteret e FDT-së shpallet i pa përgjegjshëm.

Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues ka kërkuar sqarime nga AK ku e-mali i është bashkangjitur raportit të ekspertizës lidhur me interpretimin e KRPP-së. Gjithashtu edhe sqarimi interpretimi i KRPP-së ju ka bashkëngjitur raportit të ekspertizës.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konsideron se interpretim i KRPP-së nuk është i qartë dhe shumë sqarues në mënyrë që ta shpjegon më saktësisht se a merret si e mirëqenë Sigurimi i bashkangjitur gabim ose jo, por KRPP më tepër ka interpretuar vetëm nenet 47.9, 59.2, 41.9 të LPP-së dhe RRUOPP-së, dhe në fund duke e përmbledhur tekstin me: citat’ (Sipas paragrafit 4 të nenit 59 të LPP-së, është përgjegjësi e AK që të përcaktojë devijimet në tender.)

Mirëpo vlen të theksohet se KRPP në RRUOPP tek parashtrimi i pyetjeve e ka sqaruar këtë detaj shumë qartë, pra Sigurimi i tenderit nuk i përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë e DT, në

rastin konkret është po e njëjta arsye: Neni 39 pjesa 57 të RRUOPP përcakton: Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT; Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm 57;

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe sqarimeve të dhëna nga eksperti shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve sipas kërkesave të përcaktuara në dosje të tenderit. Andaj, obligohet autoriteti kontraktues që me rastin e rivlerësimit të tenderëve të veproj konform dispozitave të LPP-së dhe nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran MILENKOVIĆ

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK -"KK-Gjakovë";
- 1x1 OE - "Joos & Kraniqi-Bazë" SH.P.K – Junik;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.